



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 216, Datë 04.07.2023

MBI

**NJOHJEN E LICENCËS PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE,
LËSHUAR NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, PËR SUBJEKTIN “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE
DYNAMICS SH.P.K.”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 97, pika 6 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pikat 4, 5 dhe 6 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; “Memorandumin e Mirëkuptimit për njohjen reciproke të licencave për veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike ndërmjet autoriteteve kombëtare rregullatore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 245, datë 06.12.2021; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1721/4 prot., datë 29.06.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike, vazhduar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për subjektin “Future Energy Trading And Exchange Dynamics sh.p.k.”,

Konstatohet se:

- Subjekti “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K.; Dega në Tiranë”, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e datës 24.03.2022, protokolluar në ERE me nr. 1721 prot., datë 01.06.2023, ka paraqitur kërkesën për njohje të licencës për furnizimin me energji elektrike, me numër ZRRE/Li_55/16, të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1734_2023, datë 05.05.2023.
- Më herët, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 117, datë 24.05.2022, ka miratuar njohjen e kësaj licence, dhënë me vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_968_2018, datë 13.04.2018.

- ERE me e-mailin e protokolluar me nr. 1721/1 prot., datë 13.06.2023, i paraqiti Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovë kërkesën për informacion në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.
- ZRRE Kosovë me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 1721/3 prot., datë 27.06.2023, ka njoftuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.
- Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga neni 4, pika 4 dhe shtojca 1/K e *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*. Po ashtu, ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të rregullores.
- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për shoqërinë “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K.”, deri më 12.04.2028.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike nr. ZRRE/Li_55/16, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_1734_2023, datë 05.05.2023, për subjektin “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K.”, që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SH.P.K., Dega në Tiranë”.
2. Njohja e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 është e vlefshme deri më 12.04.2028.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI